**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË**
**KOMISIONI I EKONOMISË DHE FINANCAVE**

**Nr** 7636/18 **Prot.** **Divjakë më** 22 / 10 / **2024**

## RAPORT

**Mbi shqyrtimin e Projektvendimeve të paraqitura nga Bashkia për mbledhjen e Muajit Tetor 2024.**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Mbështetur në nenin 17,pikat 1,2,3 të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, Nenit 33,"*Funksionimi i Komisioneve të përhershme"* në Rregulloren e Këshillit Bashkiak Divjakë;

-Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave u mblodh më datë 22 / 10 / 2024 , dhe pasi **shqyrtoi** Projekt vendimet e paraqitur nga Bashkia;

**VENDOSI:**

**1.Të** kalojë **për miratim: Projekt-vendimi** - Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga Fondi i kushtëzuar deri 6% " për bllok ndihmën " për muajin Shtator 2024.

**2.Të** kalojë **për miratim: Projekt-vendimi** - Për miratimin e një ndihme të menjëhershme për fëmijët me njërin prind ose me prindër të divorcuar.

**3.Të** kalojë **për miratim: Projekt-vendimi**. -Për ndryshime të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 64, datë 26.12.2023" Për miratimin e niveleve të pagave të Bashkisë Divjakë, Njësive Administrative dhe Institucioneve në vartësi për vitin 2024" dhe nr 65, datë 26.12.2023, " Për caktimin e niveleve të pagave të transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitin 2024.

**4.Të** kalojë **për miratim: Projekt-vendimi** - Për miratimin e "Marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Divjakë dhe Shoqatës së Gjysmëhënës së Kuqe për projektin " Ndërtim Ambulance" në fshatin Remas, Bashkia Divjakë, me vlerë investimi:1.320.521 lekë.

**Sqarim**: Mbi shqyrtimin e Projektvendimeve nga Komisioni.
1. Për miratimin e një ndihme të menjëhershme për fëmijët me njërin prind ose me prindër të divorcuar, komisioni vendosi:
1. Të rishikohet nga Bashkia lista e fëmijëve që i është bashkëngjitur projektvendimit.
2. Të bashkangjitet edhe shkresa e Ministrisë së Arsimit për fondin e akorduar në Bashki.
2. Për miratimin e ndryshimeve të VKB nr 64 dt. 26. 12. 2023 "Mbi nivelin e pagave të administratës së bashkisë, njësive administrative dhe institucioneve në vartësi për v. 2024 Komisioni vendosi që të kalojë me këto ndryshime:
1. Nënkryetarët të kenë pagë pozicioni të njëjtë sipas ligjit nr 35/2023 neni 5 pika (1c).
2. Sekretari i Përgjithshëm të vlerësohet me pagë pozicioni maksimal.
3. Sekretari i Këshillit të Bashkisë të vlerësohet me pagë pozicioni 120 000 lekë, sipas përcaktimeve ligjore, pika 3 germa (d), (ii), të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 503 dt. 01.08.2024.

Adresa:Sheshi"SantaBarbara"Qendra:Divjakë. Email:bashkia.divjakë@gmail.com

4. Drejtorët e drejtorive të vlerësohen me pagë pozicioni të njëjtë sipas ligjit nr 35/2023 neni 5 pika (c).
5. Të rishikohet paga e pozicionit të Përgjegjësave të sektoreve të kenë pagë pozicioni të njëjtë sipas ligjit nr 35/2023 neni 5 pika (c).
6. Të rishikohet paga e pozicionit të specialistëve dhe inspektorëve sipas Drejtorive përkatëse dhe Sektoreve në mbështetje të Ligjit nr 35/2023 neni 5 pika (c).
7. Të rishikohet shpërblimi mujor i Kryetarëve të fshatrave në masën deri 10% të pagës mujore të Kryetarit përkatës të Njësisë së vetëqeverisjes vendore bazuar në ligjin nr 93/2024 "Për një ndryshim në ligjin nr 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi neni 1 pika (c).

3. Të projektvendimin shtesë të ardhur më datë 22.10.2024 nga Bashkia me titull "Mbi miratimin e një ndihme me pako ushqimore për të moshuarit komisioni sugjeroi që të vendoset kriteri bazë se për sa i jepet kjo ndihmë prej 3000 lekë, në formë pako ushqimore dhe të rishikohet lista e pensionistëve, bashkëngjitur këtij projektvendimi.

Projektvendimet e mësipërme së bashku me ndryshimet e propozuara u votuan nga Komisioni me 4 (katër) vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

**KOMISIONI I EKONOMISË DHE FINANCAVE**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Liri Biti | Kryetar |
| 2. | Astrit Dervishi | zv/Kryetar |
| 3. | Gojart Agolli | sekretar |
| 4. | Fatjona Budani | anëtar |
| 5. | Jurgen Shuli | anëtar |
| 6. | Sahit Ibrahimaj | anëtar |
| 7. | Adelajda Çuli | anëtar |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA
BASHKIA DIVJAKË